
Projekt: Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për qëndrueshmërinë financiare të organizatave qytetare

KOMENTE TË LIGJIT PËR DONACIONE DHE SPONSORIZIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE DHE TË NDRYSHIMEVE DHE PLOTËSIMEVE NGA SHKURTI I VITIT 2014



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Projektin e zbatojnë:

KOHEKT

Центар за даночна политика



Projekt: Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për qëndrueshmërinë financiare të organizatave qytetare



KOMENTE TË LIGJIT PËR DONACIONE DHE SPONSORIZIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE DHE TË NDRYSHIMEVE DHE PLOTËSIMEVE NGA SHKURTI I VITIT 2014

This publication has been produced with the assistance of the European Union. The contents of this publication are the sole responsibility of Association Konekt and the authors of the content and can in no way be taken to reflect the views of the European Union.

Ky publikim është përgatitur me mbështetje të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e Shoqatës Konekt dhe autorëve të përmbajtjes dhe në asnjëfarë mënyre nuk mund të konsiderohet se i paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Autor: Katerina Hadzi-Miceva Evans, Ester Hartaj Ivana Rizenzveigova dhe Nikica Kusinikova
Redaktor: Qendra evropiane për të drejtë joprofitabile (ECNL) – Budapest dhe Shoqata Konekt Shkup
Botues: Projekt: Krijim i mjedisit të mundshëm për qëndrueshmëri financiare të OC
Për botuesin: Nikica Kusinikova, Shoqata Konekt
Përkthim në gjuhën shqipe: Lingua Eksport SHPK Shkup
Shkup, qershor 2015

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

339.726(497.7)(094.5)

KOMENTE të ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike dhe të ndryshimeve dhe plotësimeve nga shkurti i vitit 2014 / [Katerina Hadzi-Miceva Evans...i dr.]. - Skopje : Shogata Konekt, 2015. - 11 стр. ; 24 см

Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамките на проектот: "Кријим и мједисит тё мундсхём пёр qёндруесхмёри финанциаре тё ОЦ". - Автори: Katerina Hadzi-Miceva Evans, Ester Hartaj, Ivana Rizenzveigova, Nikica Kusinikova

ISBN 978-608-65655-7-2
1. Evans, Katerina Hadzi-Miceva [автор] 2. Hartaj, Ester [автор]
3. Rizenzveigova, Ivana [автор] 4. Kusinikova, Nikica [автор]
а) Закон за донации - Коментари - Македонија
COBISS.MK-ID 98880778

Vizitojeni ueb faqen e projektit "Dhuro me mençuri" në **WWW.DONIRAJPAMETNO.MK** ku do t'i gjeni të gjitha **informacionet** e nevojshme si dhe **formularët** për mënyrën dhe procedurën për fitimin e beneficioneve (stimulimeve) tatimore të cilat ju takojnë gjatë dhurimit apo sponsorimit të projekteve dhe aktiviteteve me interes publik.Ose na vizitoni në zyrën e **KONEKT** në rr. „Vladimir Polezhinovski", nr.19-1/6 në Shkup, çdo ditë pune prej orës 09 deri në orën 17. Informohuni ose caktoni takim në tel. (02) 3224198

KOMENTE TË LIGJIT PËR DONACIONE DHE SPONSORIZIME NË VEPRIMTARITË PUBLIKE DHE TË NDRYSHIMEVE DHE PLOTËSIMEVE NGA SHKURTI I VITIT 2014[1]

I. RYZEME EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij dokumenti është që të japë kthesë në ndryshimet aktuale në Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike (në tekstin e mëtutjeshëm *"LDSVP" ose "Ligji").* Ligji është miratuar në vitin 2006 me qëllim që të zgjidhen çështjet që janë paraqitur në fushën e donacioneve filantropike dhe i njëjti është ndryshuar dhe plotësuar tre herë, me revizione të fundit në vitin 2014. Ndryshimet dhe plotësimet e reja adresojnë disa çështje që paraqesin sfidë, megjithatë mbetet që të tejkalohen sfidat kryesore të Ligjit.

Pjesa e parë e dokumentit jep pasqyrë të përgjithshme të kornizës ekzistuese ligjore, e cila ka të bëjë me filantropinë. Në të diskutohet për qëllimet kryesore të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike dhe shkaqet për inicimin e procesit për miratimin e tij. Në atë kohë miratimi i Ligjit në mënyrë të përgjithshme është perceptuar si hap pozitiv, megjithatë përmes Ligjit janë identifikuar disa aspekte problematike. Sfidat kryesore kanë përfshirë mosdakordim me ligjet tjera, terminologji jokonzistente në kuadër të Ligjit dhe procedurës së ndërlikuar administrative për pasje të lehtësimeve tatimore.

Pjesa e dytë i përshkruan ndryshimet në Ligj të vendosura me ndryshimet dhe plotësimet nga viti 2014. **Ndryshimet më të rëndësishme** janë:

- Përmirësimi i funksionalitetit dhe qasjes së nxitjeve tatimore në lidhje me tatimin personal të të ardhurave, për shembull: përfitim i nxitjeve tatimore në rast të parapagesës së tatimit personal të të ardhurave;
- Zgjidhje e dallimeve mes dhënive me para dhe dhënieve pa para në dispozitat që i rregullojnë nxitjet tatimore për tatimin e vlerës së shtuar;
- Përmirësim i efikasitetit të parashtrimit të raporteve të donatorëve me atë që u mundësohet t'i parashtrojnë raportet e tyre së bashku me Raportin vjetor financiar;
- Lejimi i përjashtimeve në detyrimin për lidhje të marrëveshjeve për donacione në formë të shkruar për shoqatat dhe fondacionet, të cilat kanë status të interesit publik ose të cilat janë angazhuar në aktivitete me interes publike; dhe
- Dhënie e të drejtës dhe pranuesve që në mënyrë administrative të kërkojnë zgjidhje për vërtetim të interest publik.

Në pjesën e tretë diskutohet për **fushat e mundshme për përmirësim** me qëllim që LDSVP të jetë më funksional. Në vazhdim janë theksuar sfidat kryesore që janë identifikuar përmes Ligjit:

1 *Ky dokument është krijuar në kuadër të projektit Krijim i mjedisit të mundshëm për qëndrueshmëri financiare të OQ të financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e Qendrës evropiane për të drejtë joprofitabile (ECNL) dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian. Qendra evropiane për të drejtë joprofitabile është Qendër udhëheqëse evropiane për resurse dhe hulumtim në fushën e drejtësisë, e cila e rregullon shoqërinë civile, me seli në Budapest. Ai ka për qëllim të promovojë mjedis të volitshëm juridik dhe fiskal për shoqërinë civile në Evropë dhe ta transmetojë përvojën evropiane në pjesë tjera të botës.*

- Definicionet e termeve kyçe dhe terminologjisë së shfrytëzuar në Ligj janë jokonzistente;
- Procedura administrative për marrje të lehtësimeve tatimore është e gjatë dhe e komplikuar, pa përcaktim të qartë në atë se si përcaktohet interesi publik;
- Interesi publik ndërlidhet dhe konfirmohet për donacion/sponsorizim konkret në vend që për pranuesin;
- Ligji nuk është i harmonizuar me statusin e interesit publik të vendosur me Ligjin për shoqata dhe fondacione;
- Ligji nuk bën dallim mes pranuesve profitabilë dhe joprofitabil të donacioneve dhe sponsorizimeve;
- Ligji është restriktiv në pikëpamje të filantropisë tejkufitare;
- Dispozitat që e rregullojnë parashtrimin e raporteve dhe kontrollin e donacioneve/ sponsorizimeve nuk vërtetojnë kërkesa proporcionale; dhe
- Ligji parashikon përgjergjësi personale për përfaqësuesit e subjekteve juridike për shkelje të Ligjit pa bërë dallim mes sjelljes së qëllimshme të pakujdesshme.

II. PASQYRË E PËRGJITHSHME E KORNIZËS LIGJORE QË E RREGULLON FILANTROPINË

Qëndrueshmëria financiare është një nga sfidat kryesore, me të cilat duhet të përballen organizatat qytetare. Me qëllim që ta ruajnë qëndrueshmërinë financiare, organizatat qytetare duhet të kryejnë diversifikim të mjeteve të tyre dhe nuk mund të mbështeten kryesisht në financim nga donatorët e huaj. Një nga burimet potenciale të të ardhurave janë kontributet nga opinioni më i gjerë përmes donacioneve filantropike. Për mbështetje të donacioneve filantropike, vendet e gjithë botës kanë vendosur nxitje tatimore për donatorë potencialë individualë dhe korporativë.

Në vend, ligji i parë që i rregullon aktivitetet filantropike është miratuar në vitin 2006 me nismë të 5 deputetëve dhe me mbështetje nga një numër i madh i deputetëve nga të gjitha grupet parlamentare. Qëllimi kryesor i Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike **ka qenë që të rritet numri i dhënieve (donacioneve dhe sponsorizimeve) për veprimtaritë publike me interes publik që** (për shembull: aktivitete në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, promovim të kulturës, arsimit dhe ngjashëm), përmes vendosjes së nxitjeve tatimore për donatorët.

Miratimi i LDSVP në përgjithësi ka qenë nismë për lavdëratë. Aspektet pozitive të Ligjit përfshijnë qasje liberale në lidhje me atë se kush mund të jetë sponsor ose donator dhe si rezulat i asaj të kualifikohet për marrje të lehtësimeve tatimore. Përveç kësaj, Ligji vendos përfshirje të gjerë të sendeve të donacioneve dhe sponsorizimeve, duke përfshirë para, mallra dhe shërbime, trashëgimi dhe të drejta tjera transmetuese. Ligji ka vendosur **lloje të ndryshme të nxitjeve tatimore në lidhje me tatimin personal të të ardhurave, tatimin e vlerës së shtuar dhe tatimin e pronës.** Gjithashtu, i ka barazuar donatorët e huaj dhe vendorë në shfrytëzimin e lirimit tatimor nga tatimi i vlerës së shtuar që i nxit donatorët e huaj t'i mbështesin veprimtaritë me interes publik në vend.

Edhe krahas nismës së mirë, në Ligj ka pasur disa pjesë problematike që kanë rezultuar me komplikime në zbatimin e tij praktik. Një nga sfidat kryesore ishte zbatimi jokonsekuent i afateve kohore përmes Ligjit dhe mospajtueshmëria e dispozitave të tij me ligje tjera të ndërlidhura. Përveç kësaj LDSVP ka vendosur procedurë të ndërlikuar administrative për arritje të nxitjeve tatimore, e cila i ka kthyer donatorët potencialë.

III. REVIZIONE NGA VITI 2014

Me qëllim që të zgjidhen çështjet, të cilat paraqesin sfidë dhe që janë identifikuar përmes Ligjit, janë ngritur disa nisma për ndryshim të LDSVP-së. Deri më tani, LDSVP është ndërruar tre herë, me ndryshimet e fundit në shkurt të vitit 2014. Përgatitja e ndryshimeve dhe plotësimeve të fundit ka filluar në vitin 2012, por meqë filantropia nuk ka qenë sfera prioritare për reforma, procesi është ndërprerë. Diskutimi për LDSVP-në ka vazhduar në vitin 2013 kur Ministria e Drejtësisë (në tekstin e mëtutjeshëm: "MD") propozoi ndryshime dhe plotësime të Ligjit dhe i publikoi për debat publik. Pas marrjes së reagimeve nga palë të ndryshme të interesuara, MD vendosi që të pranojë tre propozime në lidhje me nxitjet tatimore. Si rezultat i kësaj, në shkurt të vitit 2014 Kuvendi i miratoi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit. Ndryshimet dhe plotësimet e LDSVP-së kanë qenë kryesisht të natyrës teknike, por ndryshimet në nenet që kanë të bëjnë me nxitjet tatimore për tatimin personal të të ardhurave dhe tatimin e vlerës së shtuar paraqesin hapa pozitivë drejt zhvillimit të filantropisë. Megjithatë, ndryshimet akoma nuk i zgjidhin sfidat në procedurën administrative për vërtetimin e interesit publik të donacionit ose sponsorizimit. Vendimi, me të cilin vërtetohet interesi publik është parakusht për marrje të lehtësimeve tatimore.
Ndryshimet e fundit të LDSVP-së përfshijnë disa përmirësime, të cilat janë për lavdëratë:

1. Nxitjet tatimore në raport me tatimin personal të të ardhurave janë bërë më funksional; dhe më të kapshëm për më shumë individë

Ndryshimi e nenit 13 që i rregullon nxitjet tatimore në raport me tatimin personal të të ardhurave e bëjnë gjithë konceptin më funksional. Përveç zvogëlimit të tatimit të vërtetuar, por të papaguar personal të të ardhurave për shumën e donacionit, **LDSVP tani gjithashtu mundëson kthim të tatimit personal të paguar të të ardhurave.** Kjo u mundëson individëve të marrin nxitje tatimore edhe në rastet e parapagesës së tatimit personal të të ardhurave.

Sfidë: Neni 13 nga LSDVP vërteton se individë kanë të drejtë ta zvogëlojnë tatimin për shumën e donacionit, por nuk paguajnë më shumë se 20% nga borxhi vjetor tatimor i dhënësit të donacionit, ndërsa më së shumti deri në 24.000 denarë. Duhet të shqyrtohet ideja **që të rritet limiti nga 24.000 denarë** me qëllim që të simulohen individët më të pasur të dhurojnë më tepër.[2]

2. Ndryshimet në nxitjet tatimore në lidhje me tatimin e vlerës së shtuar kanë të bëjnë me dallimet mes donacioneve me para dhe pa para

Ndryshimet dhe plotësimet teknike të nenit 15, i cili i rregullon nxitjet tatimore në lidhje me tatimin e vlerës së shtuar bëjnë dallim sistematik mes donacioneve me para dhe atyre pa para.

3. Kërkesat për parashtrim të raporteve të donatorëve janë bërë më efikase

Ndryshimet dhe plotësimet e nenit 13 dhe 14 nga LDSVP-ja sigurojnë parashtrim më efikas të raporteve të donatorëve sepse raportet e tyre do të parashtrohen së bashku me llogarinë përfundimtare. Këto dy nene i rregullojnë nxitjet tatimore në lidhje me tatimin personal të të ardhurave dhe tatimin e fitimit.

Sfidë: Neni 19 kërkon parashtrim të raportit për donacion/sponsorizim të dhënë dhe të pranuar në afat prej 30 ditëve nga plotësimi i marrëveshjes. Në bazë të kësaj dispozite, **donatorët/ sponsorët janë të detyruar t'i dorëzojnë dokumentet e njëjta deri te** Drejtoria për të ardhura publike dy herë në vit. Me qëllim që të eliminohet ngarkesa administrative e donatorëve/ sponsorëve, si dhe Drejtorisë për të ardhura publike, rekomandojmë që të tërhiqet kërkesa paraprake për parashtrim të raportit në afat prej 30 ditëve.

4. Kërkesa për lidhje të marrëveshjes në formë të shkruar për çdo donacion/ sponsorizim bëhet më pak e ashpër dhe parashikon përjashtime nga ky detyrim

Neni 4 paragrafi 2 parashikon përjashtim nga detyrimi për pranuesin dhe donatorin që të nëshkruajnë marrëveshje në formë të shkruar për donacionin. Ky përjashtim është i lejuar për shoqata ose fondacione, të cilat kanë marrë statusin e interesit publik ose kur pranuesi i donacionit është shoqatë ose fondacion i themeluar për qëllime të sigurimit të mbështetjes financiare të ndërlidhur me interesin publik.
Ndryshimet dhe plotësimet shtesë të këtij neni përfshijnë rregullim të veçantë të donacioneve telefonike dhe ngjarjeve për grumbullim të mjeteve financiare. Si praktikë e mirë evropiane, këto mënyra të donimit nënshtrohen në lirimin nga TVSH-ja.[3]

Sfidë: Do të donim t'i theksonim qëllimet e mira të ligjvënësit që ta eliminojë ngarkesën administrative që pranues të caktuar të lidhin marrëveshje në formë të shkruar. Megjithatë, neni 21 paragrafi 2 vërteton se në rastet kur nuk ekziston marrëveshje në formë të shkruar, pranuesi i donacionit duhet të dërgojë "*deklaratë me shkrim të verifikuar në noter*" kur kërkon vendim për interesin publik. Konsiderojmë se detyrimi për dërgimin e deklaratës së verifikuar në noter nuk e mënjanon ngarkesën administrative dhe në mënyrë shtesë vendos ngarkesë shtesë (taksë notere) për pranuesin. Me qëllim që ky përjashtim të jetë më efektiv në raport me kohën dhe shpenzimet, **rekomandojmë që të tërhiqet detyrimi për parashtrim të deklaratës së verifikuar noteriale.**
Përveç kësaj, neni 19 paragrafi 2 vërteton se "*domosdoshmërisht duhet të dorëzohet marrëveshja për donacion dhe sponsorizim i theksuar në nenin 4"* pa përmendje të përjashtimit nga neni 4 paragrafi 2. Me qëllim që të sigurohet konzistencë me dispozitat e kyçura në Ligj, ligjvënësit munden në mënyrë përkatëse ta ndryshojnë nenin 19.

5. Ndryshimet dhe plotësimet e LDSVP u mundësojnë edhe shfrytëzuesit edhe donatorit/sponsorit të parashtrojnë kërkesë për vërtetim të interest publik të donacionit/sponsorizimit të dhënë, respektivisht të pranuar

Ndryshimi dhe plotësimi i nenit 21 paragrafi 1 e zgjeron mundësinë edhe të pranuesve që të kërkojnë nga Ministria e Drejtësisë që ta vërtetojë interesin publik të donacionit/sponsorizimit. Paraprakisht vetëm donatorëve/sponsorëve u është lejuar ta parashtrojnë këtë kërkesë.

Sfidë: Edhe krahas kësaj nisme e cila është e denjë për lavdëratë, neni 21 paragrafi 2 vërteton se kërkesën për vërtetim të interesit publik për donacione pa përgjigje në formë të shkruar, mund ta parashtrojë vetëm pranuesi i donacionit. Me qëllim që donatorët të mos varen nga aktivitetet e pranuesve në procesin e marrjes së lehtësimeve tatimore, **rekomandojmë t'u lejohet dy palëve ta parashtrojnë këtë kërkesë.**

2 *Për më shumë informacione, shikoni: Borçe Smilevski, Qendra për politikë tatimore: Analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve nga nxitjet tatimore në Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, i kapshëm në: www.donirajpametno.mk .*

3 *Për më shumë infomacione për procedurën administrative për lirim nga TVSH-ja në ngjarjet për grumbullim të mjeteve financiare me interes publik dhe donacionet telefonike, shikojeni Shqyrtimin komparativ të ECNL për çështje të ndryshme të ndërlidhura me Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, i kapshëm në: www.donirajpametno.mk.*

4. ÇKA MBETET TË PËRMIRËSOHET QË LIGJI TË BËHET MË FUNKSIONAL

Siç kemi diskutuar, LDSVP është ndryshuar dhe plotësuar disa herë nga miratimi i tij në vitin 2006. Edhe krahas përmirësimit të pakontestueshëm të përmbajtjes së tij, akoma mbeten disa sfida që duhet të zgjidhen me qëllim që ligji të bëhet më funksional. Në vazhdim janë dhënë pyetjet që janë identikuar si sfida:

1. Definicionet e termeve kyçe dhe terminologjisë së shfrytëzuar në Ligj janë jokonzistente

Neni 3 nga LDSVP jep listë të termeve të shfrytëzuara në Ligj dhe interpretim të tyre. Edhe krahas kësaj nisme e denjë për t'u lavdëruar e ligjvënësit që t'i sqarojë termet e shfrytëzuara në Ligj, ka disa mospajtime, të cilat shkaktojnë probleme me zbatimin e tyre në praktikë.
Me e rëndësishme, **definicionet e dy termeve kyçe "veprimtari publike" dhe "interes publik" nuk janë harmonizuar,** ndërsa shtrirja e fushave që bëjnë pjesë në këto dy terme janë të ndryshme. Për shembull, edhe pse mbrojtja shëndetësore, mbrojtja e personave me nevoja të veçanta ose mbrojtja e fëmijëve konsiderohen për "veprimtari publike", ata nuk janë të kyçur në definicionin e "interesit publik". Gjithashtu, definicioni i "veprimtarive publike" nuk përmban udhëzim të promovimit të dhurimit të gjakut ose promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat janë pjesë nga definicioni i "interesit publik". Duke pasur parasysh se neni 11 paragrafi 3 parashikon se "*sponsorizimi i jepet pranuesit të sponsorizimit për implementimin e interesit publik nga veprimtaria e përcaktuar publike e definuar në marrëveshjen për sponsorizim"* nuk është tërësisht e qartë kush është shtrirja e veprimtarive që kualifikohen për marrje të nxitjeve tatimore për sponsorizime.
Ligji gjithashtu **nuk sqaron çka paraqet interes publik,** respektivisht se cili është elaborimi për këtë term. Para numërimit të fushave me interes publik, ligjet në disa shtete japin përshkrim të përgjithshëm të asaj se si ky term interpretohet. Për këtë shkak interesi publik nuk kuptohet vetëm si "*veprimtari e dobishme shoqërore, e cila kontribuon për opinionin më të gjerë",* por edhe si veprimtari, të cilën tradicionalisht e kryejnë organizatat të cilat janë themeluar për qëllime joprofitabile. [4]

Përveç kësaj, disa terme kyçe të shfrytëzuara në Ligj nuk janë kyçur në nenin 3 dhe për këtë rëndësia e tyre nuk është tërësisht e sqaruar. Për shembull, "donator" dhe "sponsor", dy terme të përdorura shpesh në LDSVP, nuk janë përkufizuar fare, ndërsa termi "pranues i donacionit" josistematikisht është përshkruar në pjesë tjetër të ligjit.
Rekomandim: Rekomandojmë që ligjvënësit ta **harmonizojnë terminologjinë** e cila është përdorur në gjithë Ligjin dhe **të japin definicione të termeve kyçe** me qëllim që të parandalohen çfarëdo qoftë konfuzione gjatë implementimi të Ligjit.

2. Procedura administrative për përfitim të lehtësimeve tatimore është e gjatë dhe e ndërlikuar, pa kuptim të qartë të asaj se si përcaktohet interesi publik

Procedura administrative për vërtetimin e interesit publik e përshkruar në nenin 21 është shumë e komplikuar dhe duhet të përmirësohet në mënyra të ndryshme. Nuk kemi informacione për çfarëdo qoftë procedurë tjetër të ngjashme në vende tjera evropiane dhe **kjo krijon peshë shtesë si për organet shtetërore ashtu edhe për palët e kyçura në donimin privat.** Në vazhdim janë dhënë sfidat kryesore në kuadër të procedurës:

4 *Për më shumë sqarime dhe shembuj për atë çka paraqet dobi publike ose interes publik, shikojeni Shqyrtimin komparativ të ECNL për çështje të ndryshme të ndërlidhura me Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, që është e kapshme në: www.donirajpametno.mk.*

- *Procedura është e gjatë dhe e komplikuar*

Procedura administrative e përshkruar në nenin 21 është e gjatë dhe e komplikuar. LDSVP fillimisht parashikon vendim/zgjidhje nga Ministria e Drejtësisë për interesin publik, megjithatë ky vendim bazohet në opinionin e "*organeve kompetente*". Kur vendimi nuk do të lëshohet në afat prej 15 ditëve, në proces përfshihen institucione shtesë me afate të reja për aktet dhe vendimet personale. Si rezultat i kësaj, gjatësia e procedurës është jokonzistente me natyrën e donacioneve/sponsorizimeve dhe vetëm krijon detyrim shtesë për institucionet përgjegjëse për kryerje të detyrave tjera. Përveç kësaj, në nenin 21 paragrafi 2 është dhënë listë e gjatë e dokumenteve, të cilat duhet të deponohen me kërkesë për interes publik të donacioneve të bëra pa marrëveshje në formë të shkruar. Kjo krijon ngarkesë asministrative shtesë për pranuesit e donacioneve.

- *LDSVP kërkon listë të vëllimshme të dokumenteve shoqëruese për vërteti të interesit publik në rast të donacioneve pa kontratë në formë të shkruar*

Derisa në rast të donacioneve/sponsorizimeve të bëra në bazë të marrëveshjes në formë të shkruar LDSVP kërkon vetëm parashtrim të marrëveshjes përkatëse, **lista e dokumenteve shoqëruese të caktuara për donacionet pa marrëveshje në formë të shkruar është dukshëm e madhe.** Kjo është në kundërshtim me idenë për eliminim të ngarkesës administrative të paraqitur me detyrimin për lidhje të marrëveshjes në formë të shkruar. Krahas kësaj, kjo gjithashtu krijon pasiguri tek donatorët se ata me të vërtetë do të marrin lehtësime tatimore, sepse pranuesit janë të detyruar të dorëzojnë pako dokumente deri te Ministria e Drejtësisë.

- *LDSVP nuk bën dallim mes shumave të ndryshme të donacioneve/sponsorizimeve, madhësisë së pranuesve ose faktorëve të tjerë të rëndësishëm gjatë vërtetimit të rregullave për marrje të vendimeve për interes publik.*

Rregullat proceduriale për marrje të vendimeve për interes publik të donacioneve/sponsorizimeve **janë të njëjta për të gjitha llojet e donacioneve/sponsorizimeve.** Kjo do të thotë se donacionet/sponsorizimet me vlerë prej 60 denarëve duhet të nënshtrohen në procesin e njëjtë të marrjes së vendimeve për interesin e tyre publik si dhe donacionet/sponsorizimet nga 60.000 denarë. Gjithashtu, madhësia e organizatës do të mund të merret parasysh gjatë vërtetimit të rregullave për procedurë administrative, sepse ajo mund të krijojë probleme të mëdha për organizata të vogla me disa të punësuar.

- *Kriteret për marrje të vendimeve për interes publik nuk janë të vërtetuara qartë*

Krahas faktit që gjithë procedura administrative është detajisht e përshkruar (neni 21 përfshin 23 paragrafe), nuk ekzistojnë kritere të qarta për atë se si caktohet interesi publik. Në ligj nuk janë përshkruar koncepti dhe elaborimi për atë që e përbëjnë interesin publik, vetëm janë theksuar fushat që bëjnë pjesë në shtrirjen e tij. Në vend të shtrirjes së gjerë të asaj se kush është përgjegjës për marrjen e vendimeve kur një organ i caktuar nuk përgjigjet ndaj kërkesës, **ligjvënësi mund të marrë parasysh vendosje të rregullave të caktuara për atë se si analizohet dhe merret vendim për interesin publik.** Neni 22 me të cilin rregullohet refuzimi i interesit publik, mundet gjithashtu në mënyrë shtesë të elaborohet dhe të vërtetohen qartë kriteret kur e drejta e nxitjes tatimore është refuzuar, në të kundërtën, Ligji lë të drejtë të gjerë diskrete të organeve.

- *Ministria e Drejtësisë duhet ta përcjellë mendimin e organeve të emëruara madje edhe nëse nuk dakordohet me të njëjtën*

Ministria e Drejtësisë është organ i emëruar me Ligjin, për marrje të vendimeve për vërtetim të interesit publik të donacioneve/sponsorizimeve. Megjithatë, kjo praktikisht nuk ka ndikim në procesin e marrjes së vendimeve, sepse e përcjellë mendimin e organit të emëruar. Si rezultat i kësaj, edhe në situatë kur Ministria e Drejtësisë nuk do të dakordohet me opinionin e organit të emëruar, ajo megjithatë duhet të marrë vendim të kundërt me mendimin e saj. Krahas kësaj nuk është rregulluar se si organet e emëruara marrin vendime dhe për shkak të kësaj gjithë procesi është bazuar në vendime diskrete. **Ligjvënësit do të duhet të vendosin detyrim për trupat e emëruar ta justifikojnë mendimin e tyre dhe të sqarojnë pse e konfirmojnë/refuzojnë interesin publik,** me mundës që MD të kërkojë sqarime/të apelojë/rihetojë vendimin e tyre.

- *Nuk ekziston siguri juridike për donacione/sponsorizime se ata do të fitojnë lehtësime tatimore pas donacionit/sponsorizimit të tyre*

Procedura e komplikuar, mungesa e kritereve të qarta për vërtetim të interesit publik të donacioneve/sponsorizimeve dhe faktit që vendimi jepet vetëm pas detyrimit të ndërmarrë për dhënie të donacionit/sponsorizimit shkakton **pasiguri juridike tek donatorët në raport me përfitimin e nxitjeve tatimore.**

Rekomandim: Ligjvënësit do të duhet ta revidojnë gjithë procedurën administrative për vërtetimin e interesit publik në bazë të lartpërmendurës **dhe të vendosin procedurë më pak të komplikuar, të shkurtër dhe të qartë** e cila nuk do të krijojë ngarkesë shtesë as për institucionet as për donatorët/sponsorët dhe pranuesit.

3. Interesi publik përcaktohet për donacion/sponsorizim konkret në vend që për pranuesin

Sfidë shtesë në lidhje me marrjen e vendimit për interesin publik të përshkruar në nenin 21 është lënda e vendimit. Interesi publik momentalisht përcaktohet në mënyrë të veçantë për çdo donacion/sponsorizim të planifikuar, pa e marrë parasysh statusin juridik të pranuesit. **Si praktikë më e mirë evropiane, nxitjet tatimore për donatorët/sponsorët ndërlidhen me formën juridike të organizatës, e sidomos me natyrën e saj joprofitabile.** Si rezultat i kësaj, kur donatori/sponsori vendos për mbështetje të ndonjë aktiviteti të një personi të caktuar juridik, tani më do të jetë e qartë nëse aktiviteti është me interes publik. Kjo mund t'i zgjedh të gjitha sfidat të ndërlidhura me procedurën administrative dhe ta eliminojë ngarkesën administrative të institucioneve shtetërore. Në dobi të kësaj, kjo do ta mënjanojë pasigurinë tek donatorët dhe sponsorët për atë nëse donimi/sponsorizimi i tyre do të japë lehtësim tatimor.

Rekomandim: U rekomandojmë ligjdhënësve që ta harmonizojnë LDSVP-në me praktikat më të mira evropiane dhe ta përcaktojnë interesin publik të donacionit/sponsorizimit në bazë të statusit juridik të pranuesit.[5]

5 *Për shembuj më konkret për atë se kush mund të jetë pranuesi i donacionit me interes publik, ju lutemi shikojeni Shqyrtimin krahasues të Qendrës evropiane për të drejtë joprofitabile për çështje të ndryshme të ndërlidhura me LDSVP, i kapshëm në: www.donirajpametno.mk.*

4. Mungesë në raport mes LDSVP dhe statusit të interesit publik të vendosur me Ligjin për shoqata dhe fondacione

Ligji për shoqata dhe fondacione i rregullon të ashtuquajturat *"organizata me interes publik".* Neni 73 i këtij ligji parashikon se *"organizatat mund të marrin status të interesit publik nëse kryejnë veprimtari të interesit publik".* Në nenin e ardhshëm, ligji parashikon listë të veprimtarive me interes publik. Megjithatë, shtrirja e këtyre veprimtarive në LDSVP është i ndryshëm dhe dispozitat e tij **nuk vendosin kurrfarë nxitje tatimore shtesë** për donacione/sponsorizime për organizata me status së interesit publik. LDSVP vetëm siguron përjashtim nga detyrimi për lidhje të marrëveshjes në formë të shkruar për donacionet/sponsorizimet të dedikuara për organizata me interes publik. Meqë nuk ekzistojnë përfitime shtesë të pranuara për këto organizata me ligje tjera, ky status praktikisht nuk është funksional. Në të vërtetë, deri në maj të vitit 2014 ka pasur vetëm një organizatë me interes publik të regjistruar në Maqedoni.

Rekomadim: Rekomandojmë **që të vendosen ose të ndërlidhen disa lehtësime tatimore me këtë status,** me qëllim që ta zgjidhë sfidën momentale me zbatimin e statusit të interesit publik në praktikë.

5. Ligji nuk bën dallim mes pranuesve profitabilë dhe joprofitabilë të donacioneve dhe sponsorizimeve

Neni 7 nga LDSVP parashikon se shfrytëzuesi i donacionit është "*një person vendor juridik*". Ngjashëm me këtë, në nenin 8 është parashikuar se "shfrytëzuesi i sponsorizimit mund të jetë çdo person vendor juridik". Në nenin 3 "*person vendor juridik*" është definuar si "*institucion publik, njësit i pushtetit lokal, shoqata qytetare dhe fondacione me interes publik, shoqëri tregtare, organe të administratës shtetërore dhe subjekte tjera, të cilat me regjistrim tek organet kompetente, kanë marrë cilësinë e personit juridik*".
Në bazë të kësaj dispozite, shoqërive tregtare dhe ndërmarrjeve tjera private u është lejuar të pranojnë donacione dhe sponsorizime për të cilat refuzohet tatimi. Megjithatë, sipas praktikave evropiane, donacionet filantropike dhe lehtësimet tatimore janë të orientuara vetëm drejt personave joprofitabilë juridikë. Ligjvënësit duhet ta marrin parasysh faktin se mundësia që të merren lehtësime tatimore edhe të donacioneve/sponsorizimeve të dedikuara për ndërmarrjet private, devijon nga mirëkuptimi i përgjithshëm i asaj që paraqet interes publik.

Rekomandim: Ligjdhënësit duhet ta shqyrtojnë sigurimin e lehtësimeve tatimore vetëm për donacione/sponsorizime për persona juridikë joprofitabilë në pajtim me praktikat më të mira evropiane.

6. Ligji është restriktiv në pikëpamje të filantropisë tejkufitare

Paragrafi 2 nga neni 7 parashikon se shfrytëzuesi i donacionit mundet gjithashtu të jetë edhe një *person i huaj juridik.* Megjithatë, ligjvënësit nuk e kanë shfrytëzuar qasjen e njëjtë gjatë rregullimit të donacioneve tejkufitare sikur për vendasit. Fillimisht, persona të huaj juridikë mund të marrin lehtësime tatimore vetëm për donacione, por jo edhe për sponsorizime. E dyta, vëllimi i veprimtarive për të cilat llogaritet se ja në me interes publik është i kufizuar në ndihmë në rast të katastrofave natyrore dhe katastrofave humanitare. Për donacione të huaja për të gjitha veprimtaritë tjera me interes publik, të cilat nënshtrohen në lehtësime tatimore

për kontribute vendore, nuk refuzohet tatim. **Ky rregullim i filantropisë tejkufitare është diskriminues dhe është në kundërshtim me praktikat e mira ndërkombëtare dhe evropiane.** Si praktikë më e mirë, donacionet tejkufitare trajtohen në mënyrë të njëjtë sikur edhe ato vendore.[6]

Rekomandim: **Rekomandojmë që të ndryshojë Ligji dhe të sigurohen nxitje tatimore për donacione/sponsorizime tejkufitare në bazë të njëjtë sikur edhe për donacionet vendore.** Kjo do të thotë se vendimi për interes publik do të jetë, gjithashtu i sjellur në bazë të njëjtë sikur edhe për donacionet/sponsorizimet vendore. Në rast të mëdyshjeve, organi mund të kërkojë nga donatori/sponsori pse pranuesi të parashtrojë dokumentacion shoqërues, me çka do të dëshmohet interesi publik i donacionit/sponsorizimit. Me qëllim të marrjes së vendimit për donacione tejkufitare të bëhet më pak komplikuar, ligjvënësit duhet ta shqyrtojnë propozimin tonë që t'i ndërlidhin nxitjet tatimore vetëm me donacione për persona juridikë joprifitabilë.

7. Dispozitat që e rregullojnë parashtrimin e raporteve dhe kontrollin e donacioneve/sponsorizimeve nuk vërtetojnë kërkesa proporcionale

Neni 19 i detyron të gjithë donatorët/sponsorët, si dhe pranuesit të përgatisin raport me shkrim për shfrytëzimin e donacioneve dhe sponsorizimeve. Detyrimi për parashtrim të raporteve të pranuesit mbi një prag të caktuar mund të jetë i kuptueshëm. Megjithatë, kërkesa që donatorët/sponsorët të parashtrojnë raport për shfrytëzim të kontributeve është në kundërshtim me praktikat më të mira evropiane dhe mjaft e dekurajon angazhimin në donimin privat.

Përveç kësaj, donatorët/sponsorët dhe pranuesit janë të detyruar t'i deponojnë me raportet, dokumentat e njëjta, të cilat tashmë janë dorëzuar deri te Ministria e Drejtësisë për qëllime të marrjes së vendimeve për interes publik. Konsideroj se kjo dispozitë është shumë e ngarkuar në aspektin administrativ dhe se mund të zgjidhet përmes komunikimit efektiv/shkëmbimit të informacioneve mes institucioneve shtetërore. Gjithashtu, formularët për raportet e donatorëve/sponsorëve dhe pranuesve janë identikë dhe si rezultat i kësaj, secili prej tyre siguron mjaft informacione për donacionin/sponsorizimin dhe parashtrimi i raporteve nga dy palët nuk ka kurrfarë vlere praktike për institucionet. Sërish, kjo vetëm krijon ngarkesë administrative për të gjitha palët e kyçura në parashtrimin e raporteve, duke përfshirë edhe institucionet publike, të cilat duhet t'i mbledhin të gjitha këto materiale.

Si çështje e praktikës së mirë, çdo lloj i parashtrimit të raporteve dhe kontrollit kryhet kryesisht në anën e pranuesit. Megjithatë, madje edhe për ata**, rregullat për parashtrim të raporteve duhet të jenë proporcional** dhe kërkojnë prej tyre të parashtrojnë raporte vetëm gjatë dhënies së shumave më të mëdha, të mbledhura për një qëllim të caktuar me interes publik (respektivisht kur organizohet grumbullim publik i mjeteve që të mblidhen donacione për ndërtimin e një qendre për kujdes të personave të verbër). Ky lloj i parashtrimit të raporteve për shfrytëzimin e mjeteve të mbledhura gjatë "grumbullimit publik të mjeteve" ekziston për shembull në Poloni, Sllovaki dhe në Republikën e Çekisë. Parashtrimi i raportit për pjesën e mbetur të donacionit është kyçur në raportet e tyre vjetore.

Përveç kësaj, dënimet për mosrespektim të kërkesave për parashtrim të raportiti të përshkruara në nenet 25 dhe 26 janë kryesisht të larta dhe lëvizin nga 1.000 deri në 5.000 euro për persona juridikë dhe nga 500 deri në 1.000 euro për personat përgjegjës të personit juridik.

6 Për më shumë hollësi për trajtimin tatimor të filantropisë tejkufitare, shikojeni Shqyrtimin krahasues të ECNL për çështje të ndryshme të ndërlidhura me Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, i cili është i kapshëm në: www.donirajpametno.mk.

Rekomandime: Do të donim t'i rekomandonim ligjdhënësit që t'i vërtetojnë kërkesat për parashtrim të raporteve në mënyrë proporcionale dhe ta tërheqin detyrimin për parashtrim të raporteve të donatorëve/sponsorëve.

8. Me ligjin rregullohet përgjegjësia personale e përfaqësuesve të personave juridikë për shkelje të ligjit pa u bërë dallim midis sjelljes së qëllimshme dhe sjelljes neglizhente

Neni 23 nga LDSVP me të cilin rregullohen sanksionet për shkelje të dispozitave të caktuara nga Ligji, në disa raste i imponon gjoba "*personit përgjegjës në personin juridik*". Megjithatë, rregullativa ligjore nuk bën dallim mes veprimit të qëllimshëm të personave përgjegjës në personin juridik, i cili i shkel dispozitat e LDSVP dhe aktiti neglizhent kur personi nuk mund të llogaritet si përgjegjës.

Gjithashtu, sanksionet dhe gjobat e vendosura me Ligjin për shkelje të dispozitave të tij në disa raste i dënojnë individët ose personat juridikë pa arsye të mirë. Për shembull, neni 23 imponon dënim në para prej 1.000 – 5.000 euro në kundërvlerë të denarit të personave juridikë – shfrytëzues, ndërsa neni 26 parashikon 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë të denarit për persona fizikë për donacion të dhënë pa marrëveshje në formë të shkruar. Megjithatë, varet nga donatori/sponsori dhe pranuesi nëse ata do të shfrytëzojnë LDSVP për donacion/sponsorizim dhe do të marrin lehtësime tatimore ose nuk do ta shfrytëzojnë dhe të paguajnë tatime siç është e zakonshme.

Rekomandim: **Do t'i rekomandoja ligjdhënësve që të bëjnë dalim të qartë mes sjelljes së qëllimshme dhe sjelljes së pakujdesshme të personave përgjegjës** dhe të mos imponojnë sanksione në rast të sjelljes neglizhente.

9. Ligji nuk rregullon situata kur qëllimi i donacionit/sponsorizimit bëhet i pavlefshëm ose është arritur me sukses pa u shpenzuar gjithë shuma

LDSVP nuk jep përgjigje në pyetjen se çka po ndodh me vlerën tjetër të donacionit/sponsorizimit kur qëllimi bëhet i pavlefshëm ose arrihet me sukses. Me qëllim që të parandalohen situata problematike, ligjet me të cilat rregullohet donacione në vendet tjera evropiane, shpesh u mundësojnë pranuesve që ta ndërrojnë qëllimin e donacionit me qëllim të ngjashëm. Megjithatë, rastet e këtilla duhet të jenë të jashtëzakonshme dhe pranuesi duhet ta informojë opinionin e gjerë dhe/ose organet shtetërore për ndërrimin e qëllimit.[7]

Rekomandim: Ligjvënësit duhet ta shqyrtojnë mundësinë për vendosje të dispositës së veçantë me të cilën do të rregullohen këto situata të jashtëzakonshme. Kjo do të sjellë rregulla të qarta për shfrytëzim të shumës tjerës të donacionit dhe do të parandalojë situata problematike, të cilat mund të dalin në të ardhmen..

7 Për më shumë informacione dhe shembuj nga vendet për këtë çështje, ju lutemi shikojeni Shqyrtimin krahasues të ECNL për çështje të ndryshme të ndërlidhura me Ligjin për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike, i cili është i kapshëm në: www.donirajpametno.mk.

SHËNIME

SHËNIME